**LIGJ**
**Nr. 75/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9707, DATË 5.4.2007 "PËR KONTROLLIN SHTETËROR TË VEPRIMTARISË SË IMPORT- EKSPORTIT TË MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË DYFISHTË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9707, datë 5.4.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 28 shtohet pika 29 me këtë përmbajtje:
"29. "Inspektimi" është formë kontrolli, me qëllim verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, i kryer në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"".

Neni 2

Në nenin 5, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:
"5. Ushtrimi i kontrollit për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore mund të bëhet nga autoriteti përkatës kompetent edhe pa paralajmërim, kur vlerësohet që një gjë e tillë mund të dëmtojë përmbushjen e qëllimit të kontrollit.".

Neni 3

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 31
**Përgjegjësia e subjekteve ligjore për shkeljen e legjislacionit në fushën e kontrollit të eksportit**

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vendos dënim kryesor me gjobë ndaj subjekteve tregtare, të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, si më poshtë:

1. Për shkeljet e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 30 të këtij ligji, në masën 500 000 - 2 000 000 lekë.

2. Për shkeljet e parashikuara në pikat 4, 5 e 6 të nenit 30 të këtij ligji, në masën 200 000 -1 000 000 lekë.

3. Për shkeljet e parashikuara në pikat 7 e 11 të nenit 30 të këtij ligji, në masën 100 000 - 500 000 lekë.

4. Për shkeljet e parashikuara në pikën 8 të nenit 30 të këtij ligji, në masën 20 000 - 200 000 lekë.

5. Për shkeljet e parashikuara në pikat 9 e 10 të nenit 30 të këtij ligji, në masën 10 000 - 100 000 lekë.".

Neni 4

Në nenin 32 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalia “Ky akt është i paankimueshëm në gjykatë” ndryshohet si më poshtë:

“Ky akt ankimohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative”.

2. Në këtë nen shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Masat e revokimit të licencës, autorizimit dhe certifikatës ndërkombëtare të importit, ose e çregjistrimit të subjekteve, sipas paragrafit të parë të këtij neni, janë dënime plotësuese administrative.”.

Neni 5

Në nenin 33, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Vendimi i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për revokimin e licencës, autorizimit dhe certifikatës ndërkombëtare të importit, ose çregjistrimin e subjektit, të përfshirë në veprimtari ekonomike me jashtë, për transferimin ndërkombëtar të mallrave, mund të ankimohet sipas rregullave të përgjithshme të ankimit, bazuar në Kodin e Procedurave Administrative.”.

Neni 6

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 34

**Autoriteti i dhënies së gjobave për shkeljet e legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit**

Gjobat e parashikuara nga neni 30 i këtij ligji, në emër të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, vendosen nga një Komision prej 3 anëtarësh, i cili krijohet dhe drejtohet nga drejtuesi i tij, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.

Kur personi i autorizuar i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vëren njërën nga shkeljet e parashikuara në nenin 30 të këtij ligji, harton një procesverbal, të cilit i bashkëlidhen shpjegimet e drejtuesit të subjektit që ka bërë shkeljen dhe të zyrtarëve të tjerë përgjegjës, si dhe dokumentet e tjera të nevojshme që vërtetojnë shkeljen, të cilat ia paraqet komisionit të autoritetit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

Në rast se shkeljet e parashikuara në nenin 30 të këtij ligji konstatohen nga zyrtari i autorizuar gjatë kryerjes së inspektimit, gjobat e parashikuara në nenin 31 të këtij ligji vendosen nga vetë zyrtari i autorizuar, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin.

Kundër vendimit të komisionit, të marrë sipas paragrafit të parë të këtij neni, mund të bëhet ankim administrativ te ministri përgjegjës për mbrojtjen dhe ndaj vendimit të ministrit mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.

Kundër vendimit të zyrtarit të autorizuar, të marrë sipas paragrafit të tretë të këtij neni, mund të bëhet ankim administrativ te komisioni i përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin dhe ndaj vendimit të komisionit, sipas këtij paragrafi, mund të bëhet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatën kompetente, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.

Gjoba paguhet nga subjekti brenda 30 ditëve. Në rast të mospagesës brenda këtij afati, zbatohet legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 7

**Dispozitë kalimtare**

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8034, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**